

# Performanca e Buxhetit 2018



## NË KËTË RAPORT

**Periudha raportimit:** Janar - Dhjetor 2018

**Statusi raportit:** Raporti bazohet në të dhëna të konsoliduara të zbatimit të buxhetit për bashkinë Mat gjatë vitit 2018 dhe është miratuar në Këshillin Bashkiak

*Përmbledhje mbi situatën financiare, të ardhurat, shpenzimet sipas programeve si edhe rezultatet kryesore të ekzekutimit të buxhetit për vitin 2018*

*Ky raport është përgatitur nga Bashkia Mat me asistencën e Projektit "Bashki të Forta". Për më shumë informacion kontaktoni Z.Dea Kaziu në adresën [deakaziu@outlook.com](mailto:deakaziu@outlook.com)*

# TË DHËNA TË PËRGJITHSHME




Popullsia: Censuri (2011) 27.260 banorë  
Rregjistri Civil 38.615 banorë  
Sipërfaqja: 493.5 km<sup>2</sup>  
Dendësia: Censuri (2011) 55.23 banorë/km<sup>2</sup>  
Rregjistri Civil 78.24 banorë/km<sup>2</sup>

Nëndarjet Administrative: 8

(1) Burrel (2) Baz, (3) Derjan, (4) Rukaj, (5) Macukall, (6) Koms, (7) Lis, (8) Ulëz

Rezultatet në zgjedhjet vendore të vitit 2015 si më poshtë:



Shpërndarja e anëtarëve:

3	Anëtarë
3	Anëtarë
3	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë

**EKZEKUTIVI** Numri i përgjithshëm i zgjedhësve të regjistruar në Bashkinë Mat për zgjedhjet vendore të vitit 2015 ishte 29.297 persona. Pjesëmarrja e votuesve në zgjedhjet e fundit lokale ishte 57%. Këshilli bashkiak përbëhet nga 21 anëtarë të grupuar midis partive politike PS, PD, LSI, PDIU dhe PR.

Kryetari i Bashkisë Mat është **Z. Nezir RIZVANI**.

Bashkia e re shtrihet thuhet në të njëjtin territor me krahinën etnografike të Matit dhe ka terren kodrinor dhe malor. Ajo shtrihet në të dyja krahët e lumit Mat dhe pyjet zënë pjesën më të madhe të territorit të bashkisë së re. Bashkia e re ka pjesë të saj parkun rajonal natyror Ulëz si dhe dy liqenet artificiale, Ulëza dhe Shkopeti, të ndërtaura për prodhimin e energjisë elektrike.

**EKONOMIA** Relievi dhe klima mesdhetare mjaft e favorshme, e cila karakterizohet nga vera e nxehtë dhe e thatë me shkëlqim të madh të diellit dhe nga dimri relativisht i butë në luginën e Matit krijon kushte mjaft të favorshme për zhvillimin e bujqësisë, frutikuturës dhe blegtorisë, përcakton si burime kryesore gjeneruese ekonomiko-financiare, bujqësinë dhe blegtorinë.

Zona e Matit ka tërhequr gjatë viteve të fundit një numër të vogël turistësh të aventurës dhe ecjes në mal për shkak të relievit shumë tërheqës malor.

# SITUATA FINANCIARE

## Bashkia ka katër objektiva strategjike

- ⇒ **Qeverisja e mirë vendore, transparente dhe gjithpërfshirëse**—Ky objektiv synon rritjen e performancës së shërbimeve të Bashkisë Mat si dhe ofrimin e shërbimeve më të mira bashkiake në drejtim të qytetarëve. Bashkia Mat duhet të rrisë kapacitetet institucionale për të menaxhuar e zhvilluar territorin si dhe për të rritur transparencën dhe llogaridhënien ndaj qytetarëve
- ⇒ **Zhvillim territorial dhe ekonomik të qëndrueshëm**—Zhvillimi i qëndrueshëm territorial i Bashkisë Mat shihet ngushtësisht i lidhur me zhvillimin ekonomik. Në këtë kontekst, politikat ekonomike janë të lidhura me karakteristikat territoriale të bashkisë dhe me potencialet të cilat gjenden në territor. Bujqësia dhe nxitja e turizmit janë dy sektorët bazë të cilët do të ndikojnë në rritjen e qëndrueshme ekonomike.
- ⇒ **Mbrojtja e mjedisit**—Pasuritë mjedisore janë ndër potencialet më të mëdha për zhvillimin ekonomik dhe territorial të bashkisë. Si rrjedhojë mbrojtja e mjedisit dhe e pasurive mjedisore është një prioritet i rëndësishëm për bashkinë
- ⇒ **Zbutja e pabarazive sociale, integrimi dhe kultura**—Si rrjedhojë e zhvillimeve të 25 viteve të fundit në bashkinë Mat dallohen pabarizi të mëdha sociale midis njësisë qendrore të Burrelit dhe njësisve të tjera administrative. Gjithashtu, jeta sociale dhe aktivitetet duhen përmirësuar në mënyrë që të arrihet kohezioni social

### 2018 Vs 2017

#### Treguesit

Norma e shpenzimeve në politikat sociale ndaj totalit të shpenzimeve  
 Norma e të ardhurave nga barimet e veta ndaj totalit të të ardhurave  
 Norma e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore ndaj totalit të të ardhurave  
 Norma e totalit të shpenzimeve ndaj totalit të të ardhurave




#### Burimi i Informacionit

"FTF 2018 - Ministria e Financave"

### Fakt 2016,2017,2018

#### Treguesit

Norma e shpenzimeve në politikat sociale ndaj totalit të shpenzimeve  
 Norma e të ardhurave nga barimet e veta ndaj totalit të të ardhurave  
 Norma e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore ndaj totalit të të ardhurave  
 Norma e totalit të shpenzimeve ndaj totalit të të ardhurave



#### Burimi i Informacionit

"FTF 2018 - Ministria e Financave"

# BUXHETI 2018

## Burimet e financimit (Buxheti i rishikuar) 2018

Transferta e pakushtëzuar


Transferta e Kushtëzuar

Transferta Specifike

Te ardhurat nga Burime të Veta

Fonde të trashëguar nga Viti I kaluar (2017)

Buxheti për vitin 2018 = 902.561 mijë lekë




## Shërbimet kryesore të ofruara dhe financuara nga bashkia

- ⇒ Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve; ndërtesat publike; shkolla; parqet dhe zonat rekreative, qendrat e kujdesit shëndetësor parësor; ndërtesat e administratës lokale etj.
- ⇒ Transporti publik
- ⇒ Ujë i pijshëm dhe kanalizime
- ⇒ Menaxhimi i mbeturinave komunale
- ⇒ Menaxhimi i sistemit të ujitjes dhe kullimit të mesëm dhe terciar
- ⇒ Fidanishte, çerdhe dhe edukim parashkollor
- ⇒ Mirëmbajtja e institucioneve të arsimit parauniversitar
- ⇒ Menaxhimi i kullotave dhe pyjeve komunale
- ⇒ Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi
- ⇒ Shërbimet sociale
- ⇒ Menaxhimi i varrezave publike
- ⇒ Menaxhimi i kadastrës të bujqësisë; tregjet bujqësore lokale dhe inspektimet
- ⇒ Aktivitete artistike, kulturore dhe rinore.

Buxheti për vitin 2018 = 766.221 mijë lekë

# TË ARDHURAT 2018



Burimi: Bashkia Mat, raporti i monitorimit 2018




# SHPENZIMET

*Bashkia Mat i kushton vëmendje gjithnjë e më shumë në rritje në shërbimeve sociale dhe infrastrukturës.*

*Programet buxhetore më të financuara, rreth 80% e buxhetit, gjatë vitit 2018 ashtu sikurse parashikohej janë:*

- A. Ofrimin e shërbimeve sociale dhe banesave sociale
- B. Infrastrukturrën rrugore (urbane dhe rurale) dhe transportin publik
- C. Emergjencat civile
- D. Arsimin (parashkollor dhe atë parauniversitar)
- E. Zhvillimi i komunitetit

% ndaj totalit te Buxhetit, 2018



Shpenzimet sipas Programeve Buxhetore në Lekë



Bazimi i informacionit: "Raporti i Menaxhimit 2018 - Bashkia Mat"

# SHPENZIMET

**Të ndara sipas aktivitetit ekonomik, shpenzimet kapitale përbëjnë 12% të totalit të shpenzimeve kurse ato operative 88%.  
Vihet re një rënie e lehtë e shpenzimeve kapitale përkundrej operative gjatë vitit 2018.**

**Në grafik paraqitet % e realizimit ndaj planifikimit, ndërsa tabela më poshtë liston investimet më të rëndësishme të bashkisë.**

## Shpenzimet sipas Klasifikimit Ekonomik

### Shpenzime



## Projektet e Investimeve

Emertimi i projektit	Vitet	Mbështetja	Planifikimi	Realizimi	% Realizimi
Bashkefinancim Ujesjellesi German	2018	2018	876,400	876,400	100.00%
Pastime meqerore lagje Drita II	2018	2019	7,235,892	5,000,000	144.72%
Rehabilitim rruga Mbetje Urbane	2017	2018	3,450,260	3,450,260	100.00%
Rikonstruksion Blloku Lagje Drita	2017	2018	12,072,014	14,484,000	83.35%
Rikonstruksion rruge dhe trotuare	2018	2018	2,932,500	2,003,400	146.38%
Rikonstruksion Shkollës 31 kamiku	2017	2018	44,433,046	73,884,286	60.15%
Rikonstruksion shkollës Bruc	2012	NuJ	11,811,744	11,811,744	100.00%
shpronosim varrezat	2018	2018	1,115,000	1,115,000	100.00%
<b>Tot Investime</b>	NuJ	NuJ	<b>83,932,856</b>	<b>112,625,090</b>	<b>74.52%</b>

0M 50M 100M 150M 50.00% 100.00% 150.00%

Buxheti i Kontraktuar Realizimi i Progrosiv nga fillimi i projekti... % Realizimi progresiv nga fillimi i proj...

# TREGUESIT E PERFORMANCËS

Rezultatet vjetore të treguesve të performancës buxhetore



Bashkia ka rritur performancën e përdorimit të fondeve buxhetore. Kjo rritje ka ardhur edhe në sajë të rritjes së transparencës së vendimarrjes bashkiake.

Të gjitha mbledhjet e Këshillit Bashkiak kanë qenë të hapura dhe pjesa më e madhe e vendimeve që detyrojnë konsultimin me publikun janë diskutuar paraprakisht me banorët.

Disa arritje të rëndësishme të përmirësimit të shërbimeve ofruar komunitetit vendor falë rritjes jo vetëm të burimeve financiare, por edhe të kapaciteteve njerëzore të bashkisë janë renditur më poshtë, tregues performance sipas programeve.



# PROGRAMI

## PLANIFIKIMI MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI

### Objektivi i programit

*Bashkia ka burime njerëzore në përputhje me nevojën për ti shërbyer popullatës lokale*

*Realizimi i shpenzimeve : 76% e vlerës së parashikuar (109.868 mijë lekë, 14% e buxhetit)*



### TREGUES PERFORMANCE:

Bashkia ka 396 punonjës, nga të cilët 126 punonjës në administratën e bashkisë

- ◆ **TP1.** Numri i punonjësve për 100 banorë
- ◆ **TP2.** Numri i akteve / dokumentave të postuar

*Vihet re se këto dy tregues nuk kanë ndryshuar që do të thotë se administrata ka qenë e qëndrueshme.*

# PROGRAMI

GJENDJA CIVILE

Objekti i programit

Ofrim i shërbimit cilësor  
të gjendjes civile

## TREGUES PERFORMANCE:

*Ky është një funksion i deleguar i bashkisë nga Ministria e Brendshme.*

- ♦ **TP1.** Numri i certifikatave të lëshuara nga zyrat e gjendjes civile

*Bashkia raporton se gjatë një viti janë lëshuar 71,804 certifikata të ndryshme nga ky shërbim për të cilin punojnë 8 persona.*



# PROGRAM

## SHËRBIME POLICORE

### Objektivi i programit

Funksionimi i forcave policore qofshin ato me kohë të plotë apo ndihmëse

*Policia bashkiake ka 14 punonjës në shërbim të komunitetit.*

*Në bashkinë Mat shërbejnë 3-4 punonjës të policisë vendore për 10,000 banorë. Ky raport tregon vështirësinë në realizimin e funksioneve nga kjo strukturë dhe megjithatë numri i gjobave dhe masave të vendosura është rreth 80 në një vit.*

### TREGUES PERFORMANCE:

- ♦ **TP1.** Numri i punonjësve të policisë vendore për banorë
- ♦ **TP2.** Numri i gjobave për kundravajtje



# PROGRAM

## MBROJTJA NGA ZJARRI DHE EMERGJENCAT

### Objektivi i programit

Ngritja e një qendre funksione për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi

Realizimi i shpenzimeve :

86% e planifikimit

(19.241 mijë lekë, 3% e buxhetit)

### TREGUES PERFORMANCE:

- ♦ **TP1.** Koha e reagimit pas njoftimit
- ♦ **TP2.** Koha për mbërritjen në vend ngjarje
- ♦ **TP3.** Numri i rasteve të ndërhyra / shpëtimeve

Policia bashkiake ka një qendër për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi, me 14 punonjës në shërbim të komunitetit.

Gjatë vitit 2018 bashkia ka ndërhyrë në rreth 80 raste, ndërkohë që koha për të mbërritur në vend ngjarje vlerësohet mesatarisht 50 minuta, ndërkohë që strukturave të qendrës u duhen 5 minuta për të reaguar menjëherë pas njoftimit.



# PROGRAM

QENDRA KOMBËTARE E RREGJISTRIMIT TË BIZNESIT

Objektivi i  
programit

Përmirësimi  
procedurave të  
regjistrimit të  
biznesit

## TREGUES PERFORMANCE:

- ♦ **TP1.** Rritja e numrit të bizneseve të regjistruara në qendër brenda një viti

*Shërbimi i regjistrimit dhe licensimit të biznesit është një funksion i deleguar pranë bashkisë nga qeverisja qendrore / Ministria e Financave dhe Ekonomisë*

*Gjatë vitit 2018 bashkia deklaron se ka kryer veprime për rreth 700 biznese pranë kësaj qendre.*



# PROGRAMI

## BUJQËSIA PYJET DHE KULLOTAT

**Objektiva të programit**  
**Rritja e sipërfaqes së tokës së punuar përmes vaditjes dhe kullimit**  
**Rritja e fondit pyjor dhe kullosor**

*Bashkia ka arritur objektivin si rrjedhojë e përmirësimit të të gjithë treguesve të performancës së këtij programi buxhetor. Bashkia trashëgoi në vitin 2016 një fond pyjor prej 52,327 ha pyje dhe kullota duke shtuar numrin e pemëve të mbjella në vit. Ku vetëm në vitin 2018 bashkia ka mbjellë mbi 14 mijë pemë (disa herë më shumë sesa viti 2015) bashkia e ka çuar fondin pyjor në 52,727 ha në fund të vitit 2018*

*Për të mbështetur ekonominë bujqësore, atë të produkteve pyjore dhe tregjeve përkatëse, bashkia ofron shërbimin e mbrojtjes së tokave bujqësore nëpërmjet mbajtjes së një sistemi funksional kullues dhe vaditës, inspektimit, monitorimit dhe mirëmbajtjes së pyjeve dhe kullotave si edhe regjistrimit të tokave bujqësore dhe lëshimit të certifikatave përkatëse.*

*Për këtë funksion bashkia ka 21 punonjës. Të dyja këto funksione janë deleguar nga qeveria qendrore pranë bashkisë në janar të vitit 2016*



### TREGUES PERFORMANCE

- ◆ **TP1.** Planet e menaxhimit të fondit pyjor dhe kullosor
- ◆ **TP2.** Rritja e inspektimit të fondit pyjor dhe kullosor
- ◆ **TP3.** Rritja e monitorimit të fondit pyjor dhe kullosor
- ◆ **TP4.** Eficienca e përdorimit të buxhetit të alokuar për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullosor
- ◆ **TP5.** Përmirësimi i fondit pyjor dhe kullosor

*Për vitin 2018 bashkia inspekton, monitoron dhe mirëmban në tërësi duke siguruar që popullata merr dru zjarri sipas planeve vendore për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave për rreth 54% të fondit të saj pyjor dhe kullosor.*

# PROGRAMI

## TRANSPORTI PUBLIK

### Objektiva të programit

**Përmirësimi i rrjetit rrugor dhe trotuareve**  
**Lehtësimi i lëvizjes së banorëve në zonat rurale dhe pastrimi i rrugëve nga dëbora**  
**Përmirësimi i infrastrukturës së transportit të administratës së bashkisë për ofrimin e shërbimeve vendore**

Për të përmirësuar transportin dhe lëvizjen e banorëve dhe mjeteve si një parakusht për një jetesë të mirë dhe zhvillim të ekonomisë dhe biznesit bashkia ka vendosur tre objektiva të cilat rezultojnë se i ka realizuar më së miri përgjatë vitit 2018.

Bashkia ka rreth 40 punonjës që merren me infrastrukturën rrugore goftë në qytetin e Burrelit apo në zonat rurale të saj.

Investimet e kryera për përmirësimin e infrastrukturës rrugore kapin vlerën rreth 14 milionë lekë për vitin 2018.

### TREGUES PERFORMANCE

⇒ **Zgjerimi i rrjetit rrugor:**

- Rrugë rurale
- Rrugë urbane

⇒ **Efiçienca e alokimit të buxhetit për përmirësimin e infrastrukturës rrugore:**

- Rrugë rurale
- Rrugë urbane

⇒ **Përmirësimi i sigurisë rrugore**

Në sajë të një pune të lavdërueshme bashkia ka mirëmbajtur rrugë dhe trotuare kryesisht në zonën urbane të saj rreth 128 mijë metra katrorë. Bashkia synon të mbajë të njëjtin ritëm edhe për vitet e ardhshme.

Për ti ardhur në ndihmë banorëve në zona rurale bashkia ka mirëmbajtur dhe pastruar nga bora rreth 402 km linear rrugë. Kjo ka lehtësuar lëvizjen sidomos gjatë sezonit të dimrit.

Gjatë vitit bashkia arriti të mirëmbajë më shumë sesa gjysmën e automjeteve që ka në përdorim për punonjësit e saj, synimi i bashkisë është që ti mirëmbajë të gjitha mjetet në përdorim.



# PROGRAMI

## MENAXHIMI MBETJEVE BASHKIAKE

### Objektiv i Programit

Përmirësimi i jetës së qytetarëve përmes mjediseve të pastra

Bashkia arrin të grumbullojë mbetjet bashkiake nga të gjitha pikat e grumbullimit / kazanat 1.1 m<sup>3</sup> të saj e cila mbulon rreth 50% të të gjithë territorit të bashkisë. Pastrimi i qytetit bëhet një herë në ditë në zonën urbane të bashkisë. Përgjatë 6 muajve të vitit bashkia arrin ti lagë rrugët e qytetit dy herë në ditë duke përfshirë një sipërfaqe prej 56 mijë metra katrorë sipërfaqe e cila edhe fshihet me fshesë, ndërkohë që një sipërfaqe tjetër që pastrohet me makineri është prej më shumë se 68 mijë metra katrorë



### Tregues Performance

- ♦ **TP1.** Numri i pikave të grumbullimit të mbetjeve bashkiake
- ♦ **TP2.** Sipërfaqja e bashkisë e cila mbulohet me shërbim (grumbullim; lagje dhe pastrim me makineri)



# PROGRAMI

## SHËRBIME PUBLIKE VENDORE

### Objektiv i Programit

#### Sigurimi i një mjedisi të gjelbër

Bashkia punon për të rritur hapësirat shlodhëse / rikrijuese publike, gjelbërimin e rrugëve dhe ambjenteve publike, rregullimin e trotuareve të prishura, ndërtimin-rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike etj.

Për të siguruar shërbime të kënaqshme publike bashkia ka rreth 40 punonjës

Bashkia ka arritur të krijojë dhe vazhdimisht kujdeset për një hapësirë të gjelbëruar me pemë dhe bimë dekorative në një sipërfaqe prej 100 mijë metra katrorë.

Kjo do të thotë se në bashkinë Mat një banor ka një raport prej rreth 3 metra katror sipërfaqe të gjelbër.

Gjatë vitit 2018 bashkia ka riparuar rreth 3 kilometra trotuare dhe mirëmbajtur varrezat publike për një sipërfaqe mbi 22 mijë metra katror.

### Tregues Performance

- ♦ **TP 1.** Raporti i sipërfaqes së gjelbëruar kundrejt sipërfaqes totale të bashkisë (në %)
- ♦ **TP 2.** Rrënjë pemë të mbjella kundrejt totalit të pemëve për të cilat kujdeset / fondi pemëve të bashkisë (në %)
- ♦ **TP 3.** Total km linear trotuar kundrejt vitit të kaluar (ndryshimi në %)
- ♦ **TP 4.** Rritja e efijencës buxhetore në ofrimin e shërbimit të gjelbërimit (Lekë të ardhura nga tarifa e gjelbërimit kundrejt totalit të të ardhurave nga tarifat vendore (në %)



# PROGRAMI

## SHËRBIMI I UJIT TE PIJSHËM DHE KANALIZIMEVE

### Objektiv i Programit

### Rritja e popullatës me shërbim cilësor

*Bashkia mbulon gjithë komunitetin e saj me shërbimin e ujit të pijshëm dhe mbi 79% të popullatës me kanalizime sanitare.*


*Ky mbulim i mirë me shërbim vjen si rrjedhojë e menaxhimit shumë të mirë të tarifave duke mundësuar mbulimin e kostos së shërbimit në një nivel të lartë.*

*Bashkia ofron rreth 18 orë ujë të pijshëm në ditë - natë. Kostot operative mbulohe rreth 130% nga të ardhurat e tarifave për ujin e pijshëm dhe sistemin e kanalizimeve, ndërkohë që kostot totale të shërbimit mbulohe rreth 90% nga këto të ardhura.*

*Bashkia synon që të mbulojë tërësisht kostot e shërbimit për të mundësuar rritjen e kohëzgjatjes së ofrimit të ujit të pijshëm dhe cilësisë së tij*

### Tregues Performance

- ◆ **TP1.** % e popullatës mbuluar me ujë të pijshëm
- ◆ **TP 2.** % e popullatës mbuluar me kanalizime sanitare
- ◆ **TP 3.** % e kostos së shërbimit të ujit të pijshëm e mbuluar nga tarifa
- ◆ **TP 4.** % e kostos së shërbimit të kanalizimeve e mbuluar nga tarifa
- ◆ **TP 5.** Norma e arkëtimit të të ardhurave
- ◆ **TP 6.** Koha e ofrimit të ujit të pijshëm në 24 orë



# PROGRAMI

## NDRIÇIMI I RRUGËVE

### Objektiv i Programit

#### Rritja e cilësisë së jetesës së banorëve

Bashkia ofron siguri në komunitet duke administruar, instaluar mirëmbajtur dhe vënë në funksionim sistemin e ndriçimit të rrugëve dhe mjediseve publike

Bashkia arrin të ndriçojë hapësirat e saj publike në rreth 128 mijë metra katror për rreth 10.14 orë të natës në 3 njësi administrative të saj

### Tregues Performance

- ♦ **TP1.** Rritja e sipërfaqes së ndricuar nga njëri vit në tjetrin
- ♦ **TP2.** Orë ndricim në vit
- ♦ **TP3.** Numri i njësive administrative që marrin ndricim të rrugëve nga bashkia



# PROGRAMI

## SHËRBIME SPORTIVE

### Objektiv i Programit

**Rritja e cilësisë së jetesës kulturore dhe sportive të komunitetit vendor**

Bashkia vë në funksionim struktura për veprimtari ose ngjarje sportive si fusha lojërash, palestra etj mbështetjen e ekipeve përfaqësuese vendore në veprimtari të sportive, mbështetjen e strukturave për veprimtari ose ngjarje sportive.

Gjatë vitit 2018 bashkia ka mbështetur rreth 28 aktivitete të ekipit të futbollit dhe 8 aktivitete shumësportesh.

### Tregues Performance

- ♦ **TP1.** Numri i aktiviteteve të futbollit të zhvilluara në vit
- ♦ **TP2.** Numri i aktiviteteve shumësportesh të zhvilluar në vit (ciklizëm, pingpong etj.)



*Realizimi i shpenzimeve :  
95% e vlerës së parashikuar  
(15.322 mijë lekë, 2% e  
buxhetit)*

# PROGRAMI

## SHËRBIME KULTURORE

### Objektiv i Programit

**Pasurimi dhe gjallërimi i jetës kulturore dhe artistike të komunitetit lokal**

*Bashkia zhvillon, mbron dhe promovon vlerat e trashëgimisë kulturore si dhe administron disa objekte kulturore në territorin e saj. Për të siguruar jetë kulturore dhe artistike bashkia ka një staf me 16 punonjës të kulturës dhe artitit që mbështesin për mirëvajtjen e këtij shërbimi .*

*Gjatë vitit 2018 bashkia ka organizuar rreth 15 aktivitete ku kanë marrë pjesë rreth 200 banorë të komunitetit lokal. Ndërkohë që numri i lexuesve që kanë frekuentuar bibliotekën ka qënë 1200 persona dhe ai i vizitorëve në muze rreth 1000 persona.*

### Tregues Performance

- ◆ **TP1.** Numri i aktiviteteve të kryera në vit
- ◆ **TP2.** Numri i pjesëmarrësve në aktivitete
- ◆ **TP3.** Numri i lexuesve / anëtarëve të bibliotekës në vit
- ◆ **TP4.** Numri i vizitorëve në muze



# PROGRAMI

## ARSIMI BAZË DHE PARASHKOLLOR

### Objektiv i Programit

Rritja e efektivitetit të përdorimit të fondeve të bashkisë  
Promovimi i nxënësve të dalluar

*Realizimi i shpenzimeve :  
100% e vlerës së parashikuar  
(56.196 mijë lekë, 7% e  
buxhetit)*

*Bashkia ka rreth 116 punonjës në sistem nga të cilët edukator 97 dhe ndihmës 19 për institucionet e sistemit 9 vjecar dhe parashkollor.*

*Bashkia ofron shërbimin e mirëmbajtjes, ndërtimit dhe mbështetjes së aktiviteteve mësimore në 41 kopshte dhe shkolla të saj.*

*Gjatë vitit të kaluar bashkia ka përmirësuar kushtet e zhvillimit të mësimit në kopshte dhe shkolla duke lyer dhe mirëmbajtur mbi 25 mijë metra katror sipërfaqe të këtyre institucioneve / ndërtesave të tyre*

*Bashkia synon ti promovojë nxënësit e dalluar duke i përfshirë / mbështetur ata në aktivitete të ndryshme artistik. Gjatë vitit 2018 bashkia ka promovuar rreth 360 nxënës të shkollave 9 vjecare dhe ata të parashkollorit.*

### Tregues Performance

- ♦ **TP1.** Numri i personelit në arsimin bazë dhe parashkollor për një fëmijë
- ♦ **TP2.** Sipërfaqe e shkollave dhe kopshteve të mirëmbajtura gjatë vitit (m2)
- ♦ **TP3.** Numri i shkollave dhe kopshteve të mbështetura
- ♦ **TP4.** Numri i fëmijëve që marrin pjesë në aktivitete të mbështetura nga bashkia
- ♦ **TP5.** Numri i nxënësve të promovuar / mbështetur



# PROGRAMI

## ARSIMI I MESËM

### Objektiv i Programit

Mbarëvajtje e arsimit të mesëm nëpërmjet mbulimit të pagave për personelin dhe mundësi i arsimit profesional

*Bashkia siguron ndërtimin dhe mirëmbajtjen e shkollave në sistemin parauniversitar goftë profili i mesëm i përgjithshëm apo shkolla profesionale dhe konvikteve të tyre.*

*Gjatë vitit 2018 bashkia ka vënë në dispozicion të shkollave rreth 100 m3 dru për zjarr duke përmirësuar ngrohjen e nxënësve në ambjentet e shkollave dhe mbështetur me bursë rreth 66 nxënës .*

### Tregues Performance

- ◆ **TP1.** Numri i personelit në arsimin e mesëm për një nxënës
- ◆ **TP2.** Dru për ngrohje në sistemin parauniversitar (në m3)
- ◆ **TP3.** Numri i nxënësve që përfitojnë bursë



*Realizimi i shpenzimeve : 40% e vlerës së parashikuar (13.056 mijë lekë, 2% e buxhetit)*

# PROGRAMI

## SHËRBIME SOCIALE

### Objektiva të Programit

Mbështetje më e mirë e personave me aftësi të kufizuar  
përmes skemës së PAK dhe NE  
Mbështetje e shtresave në nevojë përmes skemës së NE

Bashkia ofron përfitime monetare ose në natyrë si asistencë për detyrat e përditshme për personat të paaftë për punë për shkak të sëmundjeve ose dëmtimit.

Gjatë vitit 2018 bashkia ka mbështetur rreth 1,460 persona me aftësi të kufizuar

Gjatë vitit 2018 bashkia ka mbështetur rreth 1300 persona në nevojë me ndihmë ekonomike. Bashkia ka një personel në çerdhe prej 19 vetash të cilët u shërbejnë rreth 1 punonjës për 6 fëmijë.

### Tregues Performance

- ♦ **TP 1.** Numri i familjeve që përfitojnë NE
- ♦ **TP 2.** Numri i personelit për një fëmijë që frekuenton çerdhen

Realizimi i shpenzimeve : 100%  
e vlerës së parashikuar  
(279.747 mijë lekë, 37% e  
buxhetit)

